

VËSHTRIM ROMANIT “VDEKJA MË VJEN PREJ SYVE TË TILLË” TË REXHEP QOSJES

Arbana AJDINI

Universiteti i Tetovës

Abstrakt

Kritikët letrar shkrimtarin Rexhep Qosje e kanë vlerësuar si një nga postmodernistët e parë të letërsisë shqipe. Shenjat treguese të postmodernizmit krijues të Rexhep Qosjes dalin në sipërfaqe që në romanin e tij të parë, “*Vdekja më vjen prej syve të tillë*”, ku ka sjellë risi të shumta si në përmbajtje e formë, po ashtu edhe në aspektin letrar e gjuhësor, duke sjellë risi edhe në mënyrën e përdorimit të figurave stilistike etj. Në veçanti kritikët letrar përmendin trajtimin dhe mbarështimin e personazheve që ai trajton dhe shtjellon në prozën e tij romaneske.

Në roman “*Vdekja më vjen prej syve të tillë*” shkrimtari përfshinë disa veçori të ligjërimit modern e postmodern, si për nga teknikat e rrëfimit narrativ në mënyra të ndryshme, duke pasqyruar realitetin e shoqërisë, gjë të cilën e bën në mënyrë të jashtëzakonshme përmes pasqyrit të figurave stilistike të ironisë e sarkazmit, që shfaqen tek ngjarjet e krijuara nga personazhe të ndryshëm.

Me një mjeshtëri artistike të jashtëzakonshme ka arritur që përmes personazheve të trajtoj krizën e identitetit, për të kuptuar vendin e tyre në botën tonë shqiptare, po ashtu edhe rolin e tyre në shoqëri, si një nga temat kryesore të postmodernizmit. Në roman ligjërimi postmodern bëhet edhe më i veçantë pasi shkrimtari ka ditur të luaj me rendin kronologjik si dhe me vijueshmërinë logjike të ngjarjeve me të cilën rrethohen dhe ballafaqohen personazhet.

Ky roman edhe pse i pari i këtij lloji në letërsinë tonë kombëtare është i përbërë dhe dallohet nga disa aspekte shumë të rëndësishme gjatë mbarështimit të tij, si në trajtimin e vlerave universale, edukimin shoqëror dhe ndjekjen e vlerave historik, konteksti social dhe politike në tërësi.

Fjalë kyçe: identiteti, ligjërimi postmodern, vlerat universale, ironia, sarkazma.

Rexhep Qosja njihet si studiues i thellë i letërsisë shqipe, por në ndërkohë ai iu qas edhe krijimtarisë letrare në prozë. Marrë në tërësi, studiuesit e romaneve të Rexhep Qosjes thonë se ai bëri ndryshimin e madh drejt romanit shqiptar postmodernist. Me romanin e tij të parë “*Vdekja më vjen prej syve të tillë*” ai ndryshoi edhe përfytyrimin e romanit shqiptar, i cili u lexua me shumë kureshtje nga lexuesit dhe studiuesit e kohës e që u prit me entuziazëm të madh për këtë kthesë postmoderniste në prozën tonë artistike. Sot, Akademik Qosja përmendet si një ndër figurat qendrore të letërsisë shqipe, veçmas i frymës postmoderniste në letërsinë tonë artistike. Këtë vepër autori e shkroi në kohën kur ishte në kulmin e pjekurisë letrare artistike, i cili kishte edhe një autonomi të thellë krijuese. Ai i hyri romanit duke depërtuar në labirintet misterioze të pushtetit të kohës, kur autori e krijoi me shumë sukses këtë roman, i pari i tij, por edhe i pari i këtij lloji, si nga thellësia misterioze e kohës, po aq edhe nga thellësia e krijimit postmodernist në letërsi. Romani sa është i përkufizuar me botën shqiptare, veçmas në kohën e Jugosllavisë së dikurshme, romani premt për një universalitet, që tregon se shkrimtarët e mëdhenj janë të prirur për tema universale.

Rexhep Qosja është një nga figurat kyçe të letërsisë dhe kritikës letrare shqiptare, i njohur si pionier i postmodernizmit brenda fushës së letërsisë, veçmas të romnit shqiptar. Kontributet e tij në krijimtarinë letrare kanë ndikuar ndjeshëm në evoluimin e rrëfimit në letërsinë shqipe, duke futur një këndvështrim të freskët dhe një stil unik dhe të veçantë në prozën shqipe. Rexhep Qosja këtë rrugëtim e filloi duke e shkruar romanin e veçantë të quajtur “*Vdekja më vjen prej syve të tillë*”, i cili trajton ide të rëndësishme, përmes stilit të tij të veçantë të shkruarit i

njohur si posmodernizëm. Ky roman është botuar në pjesë-pjesë në revistën “Jeta e Re “ në vitin 1973 në Prishtinë, ku akademiku Rexhep Qosja ka përdorur pseudonimin, Luan Dukagjini. Gjatë historisë së krijimeve letrare, shumë shkrimtar revoltën e tyre kundër sistemeve dhe ideologjive të ndryshme e kanë shprehur në veprat e tyre. Në letërsinë shqipe kemi një numër të konsiderueshëm të shkrimtarëve që revoltën e tyre kundër sistemit dhe ideologjisë komuniste, por edhe pushtuesit jugosllav, e kanë shprehur në krijimet e tyre letrare. Një ndër ato shkrimtarë është edhe Rexhep Qosja, i cili në romanin e tij “*Vdekja më vjen prej syve të tillë*” ka kritikuar dhe ka ironizuar përmes personazheve të tij të trajtuar në mënyrën më të mirë të mundshme artistike, të cilët, me apo pa dëshirë, kanë përfaqësuar agresivitetin e sistemit jugosllav, i cili ka qenë shumë i angazhuar kundër qenies sonë kombëtare.

Shenjat treguese të postmodernizmit krijues të Rexhep Qosjes dalin në sipërfaqe që në romanin e parë të tij “*Vdekja më vjen prej syve të tillë*”, ku „*gërshetohen simbolika dhe realiteti, e mira dhe e keqja, jeta dhe vdekja, ëndrra dhe zhgjëndrra, besime në çudinë dhe besimi në jetën, pesimizmi dhe optimizmi*”.¹

Rexhep Qosja në prozën shqiptare ka sjellë risi, që në romanin e parë ku, këto risi i vërejmë që nga përmbajta, pasi ky roman është i shkruar në 13 tregime, në të cilat paraqitet „*drama e një periudhe të rëndë të një kombi, që nuk është vështirë të njohim se cili është, megjithëse shkrimtari e kamuflon dhe i jep përmasa të gjera*”.²

Në këtë roman ligjërimi postmodern bëhet edhe më i veçantë pasi autori ka ditur të luaj me rendin kronologjik si dhe me vijueshmërinë logjike të ngjarjeve, duke filluar me qytetin Vajazani që e përshkruan si një vend me shumë mullenja, tregon mënyrën se si banorët janë përgjuar në fshehtësi, janë përndjekur dhe terrorizuar njëkohësisht.

Një element shumë i rëndësishëm që na shfaqet në roman është edhe paragjykimi i shoqërisë, të cilët kishin një arsimim të ulët, pasi ishin të prirë të paragjykonin personat me nevoja të veçanta, pa u ndalur të shikonin problemet e tyre të panumërta. Ky paragjykim i shoqërisë për personazhin Trashja, e cila paragjykohet e përqeshet nga rrethi shoqëror, por edhe nga familja e saj, veçanërisht torturohej nga i vëllai, i cili e merrte litarin e lagur me ujë dhe e maltretonte pafundësisht, pasi e llogariste si budallaçkë, sepse ajo kishte humbur disa ditë nga shtëpia. E gjithë kjo bëhej se kjo vajzë e humbur ua merr fytyrën familjes së Dervishit të Mukalilit. Sipas paranojave të kësaj shoqërie, edhe njeriu i sëmurë mundet që të ua zbeh hierarkinë familjes zë tyre.

Fatkeqësisht ky ishte realiteti, ishte realiteti i shoqërisë sonë të asaj kohe, ku na shfaqet hierarkia, me të cilën funksiononte bota në atë kohë, ku përçmohej edhe jeta e artistëve nga të gjitha anët dhe objekti banesor ku jetonin. Kjo ndodhte duke ushtruar dhunë psikologjike, gjë e cila ndodhte nga persona me funksione të larta shtetërore. Një torturë të rëndë psikologjike pëson edhe personazhi Nderim, i cili jetonte në katin e parë të një objekti banesor. Personazhi në fjalë kishte botën e tij prej artisti, por kishte edhe përshtypjen e hidhur se njeriu i sinqertë dhe i ditur nuk kishte mundësi të duronte dhe të jetonte në rrethana kaq të ulëta shoqërore. Personazhin e shikojnë nga katet e pallatit, sikur nuk do të jetë njeri i kësaj bote, por sikur ka zbritur njeriu i çuditshëm... Kjo gjendje ishte një jetë e padurueshme dhe tepër ironike.

Me një mjeshtëri artistike të jashtëzakonshme, autori ka arritur që përmes personazheve të krijoj krizën e identitetit, për të kuptuar vendin e tyre në botë, po ashtu edhe rolin e tyre në shoqëri, një nga temat më të rëndësishme të postmodernizmit. Kufizimet e të drejtave të shqiptarëve, sidomos ndalimi i përdorimit të flamurit, përbënin një pengesë identitare. Përmes personazhit Danjollit i Sherkës, i cili ishte agjent i Sigurimit, Rexhep Qosja nxjerr në pah mënyrën se si bëhet shkatërrimi i shenjtërisë tek shqiptarët, pra duke ua mohuar simbolin etnik, flamurin, njëkohësisht duke e përdhosur dhe fyer institucionin e xhamisë, duke i shkaktuar dëme të thella

¹Hasan Mekuli, *Romani shqiptar, Libri shkollor*, Prishtinë, 2000, f. 191.

²Hasan Mekuli, *Romani shqiptar, Libri shkollor*, Prishtinë, 2000, f. 191.

shpirtërore popullit shqiptar. Me një fjalë, populli prekej më së shumti aty ku lëndohej thellësisht në tërë qenien e tij kombëtare.

Rexhep Qosja në roman ka ditur më së miri të përshkruaj ngjarje të larmishme të ndodhura në periudhën e sistemit jugosllav komunist me një ideologji të pamëshirshme ndaj shqiptarëve, ku na paraqet jetën e intelektualit Xhezairi i Gjikës, si një personazh shumë interesant. Ai përfaqëson ide dhe ndjenja të ndryshme, gjë që e bën një personazh të veçantë dhe të ndërlikuar. Ai është një njeri që ka shpresa dhe ëndrra të mëdha, por gjithashtu përballet me shumë situata të vështira dhe të trishtuara. Ai tenton të tejkaloj çdo vështirësi në jetë edhe pse i vetëdijshëm se tërë të këqijat i vijnë nga mjegullnajat e pushtetit jugosllav.

Në romanin *“Vdekja më vjen prej syve të tillë”*, narratori i ngjarjeve është Xhezairi i Gjikës. Gjatë zhvillimit të romanit, autori përmendën personazhin Siri, i biri i Bals, thotë se për ta kuptuar Xhezairin e Gjikës, lexoni me kujdes rrëfimet e tij, të mendoni gjatë për të si për vete. Momente kur shpirtërorja e trazuar krijon tërmet më vete. Pastaj tregon se në thellësi shpirtërore munden të hyjnë vetëm ata individë që kanë formuar qëndrimet dhe identitetin e tyre, ata janë në gjendje të kuptojnë vërtetë të tjerët dhe të nxisin tolerancën dhe bashkëjetesën e vërtetë. Në brendi të romanit autori eksploron temat me plot sfida, duke theksuar luftën e një komunitetit për të ruajtur kulturën dhe traditat e tij përballë kolonizimit.

Xhezairi i Gjikës gjatë gjithë kohës do të përballet me agresivitetin e pushtetit, si i akuzuar për thyerje të parimeve dhe ligjeve, pra duke i dëgjuar radiostacionet e huaja, gjë për të cilën do të torturohet egërsisht nga sistemi antinjerëzor jugosllav i asaj kohe, konkretisht nga Sigurimi Shtetëror. Megjithatë, Xhezairi vazhdon të mbronte veten duke thënë se populli *„do të emancipohet shpejt, në sajë të kujdesit të partisë sonë komuniste, që në kohë e ka kuptuar dyfytërsinë e klerit dhe dëmin e fesë.”*³ Nga fjalët e tij kuptot se ky personazh *„bën thirrje për individualitet krijues dhe liri krijuese, por pa e dërguar kurrë deri në pikën kulmore të refuzimit total të diktaturës pushtetare.”*⁴ Xhezair Gjika na shfaqet si një personazh hero që na tregon se si të jemi të fortë dhe të mos dorëzohemi, edhe kur ndodhin gjëra të këqija në jetë.

Ky sistem përveç që shkatërroi jetën e shumë intelektualëve shqiptarë, ai arriti që të hynte edhe në familje e në shoqëri duke i shkatërruar shpirtërisht. Sistemi totalitar ishte si një kështjellë magjike, që, ai që hynte në brendinë e saj lidhej me të, pra ishin të detyruar që t'i pranonin krimet që nuk i kishin kryer asnjëherë. Ky ishte një fenomen që i goditi rëndë shqiptarët e asaj kohe. Mirëpo, kjo kështjellë do të rrëzohet, duke nënkuptuar vetëvrasjen e Danjollit të Sherksë, pra përfundimi i një epoke që la gjurmë shumë të rënda në shoqërinë shqiptare.

Rexhep Qosja në romanin e tij përmend shqiptonjën si simbol etnik të shqiptarëve, duke sugjeruar se ata janë në një kërkim të vazhdueshëm për liri, pra *„pa i parë edhe njëherë shqiptonjat si ngjiten krenare në mbretërinë e tyre të lirë.”*⁵ Kjo tregon se historikisht shqiptarët kanë pasur lidhje të fortë me shqiptonjën e që i bënte të pavdekshëm ndaj të gjitha sfidave jetësore e historike.

Ky roman është i përbërë nga disa aspekte shumë të rëndësishme, si trajtimi i vlerave universale, edukimi dhe ndjekja e vlerave, konteksti social dhe politik, etj. Qosja shkruan në një mënyrë ku përdor shumë krahasime krijuese dhe fraza të veçanta që i bëjnë ndjenjat dhe idetë më të forta.

Në përfundim, romani *„Vdekja më vjen prej syve të tillë”* është një krijim që stimulon lexuesin të reflektojë mbi jetën, vdekjen dhe rolin e historisë në formimin e identitetin tonë kombëtar dhe personal. Romani në fjalë mbetet një nga romanet më të dashura dhe të vlerësuara të Qosjes, i cili u paraqytur si një pasqyrë e kohës së tij dhe një dëshmi e ironisë për të shprehur të vërtetat e hidhura të shoqërisë shqiptare nën diktaturën komuniste jugosllave. Duket qartë se romani i Qosjes do i mbijetonte kohës dhe gjithmonë do të ketë rëndësi të madhe në letërsinë

³Rexhep Qosja, *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, Toena, Tiranë, 2001, f. 113

⁴Nysret Krasniqi, *Letërsia e Kosovës*, AIKD, Prishtinë, 2016, f. 246.

⁵Rexhep Qosja, *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, Toena, Tiranë, 2001, f. 171

shqipe dhe më gjerë. Duket se autori paralajmëron shoqërinë se njeriu i thjeshtë dhe pushteti i ligë mund ta metaforizoj fajin e tij nga vetja dhe duke i dhënë kahe tjetër.

Referencat

- [1]. Aliu, Ali, Rrjedha dhe gjenerata në prozën tonë, Jeta e re, Prishtinë, 1974
- [2]. Krasniqi, Nysret, *Letërsia e Kosovës*, Prishtinë, 2016
- [3]. Krasniqi, Bajram, Komunikime letrare, Prishtinë, 1980
- [4]. Mekuli, Hasan, *Romani shqiptar, Libri shkollor*, Prishtinë. 2000
- [5]. Qosja, Rexhep, *Vdekja më vjen prej syve të tillë, Toena*, Tiranë, 2001
- [6]. Rugova, Ibrahim, Interpretime metodologjike e teknike të kritikës letrare, Jeta e re, Prishtinë, 1974